

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja individuale Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.A nga P, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.258/2015 të datës 18.11.2016, pas seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrveshjes për pranimin e fajsisë, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 04.07.2017 në praninë e Prokurorit të shtetit Javorka Prlinqeviq, të pandehurit V.A, me mbrojtësin me autorizim av.A.R, të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V.A, i biri i R dhe nënës Z e vajzërisë B, i lindur me *data e lindjes*, në K tani me vendbanim ne P lagja “...” rruga” Sh Sh ” blloku .. llam, . nr .., ka të kryer shkollim superior me profesion inxhinier, punon në BKS, i martuar babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar–shtetas i Republikës se Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr.personal *numer personal*,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, pasi më parë ka siguruar dhe gjer me datë 03.04.2014 ka mbajtur ne pronësi armën në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par 1.2 dhe nenin 17 par 1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, për të cilën armë me ligj kërkohet leja dhe atë, një pistoletë të tipit Broving Yapn Fabrik të kalibrit 7.65 mm me nr. ser. BB87546 me një karikator me 24 fishekë të kalibrit 7.65x17 mm, në atë mënyrë që ditën kritike në lagjen ... rr “Sh Sh blloku ..- nr. .. Prishtinë, gjatë bastisjes me urdhër të gjykatës nga zyrtarët policor i është gjetur pistoleta e sipërcituar dhe e njëjta i është sekuestruar,

- me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 46, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe neneve 233, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **450 € (katërqind e pesëdhjetë euro)**, të cilin dënim obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, e jo më gjatë se tre muaj pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë, gjykata do t'ia shëndrrojë në dënim me burg duke llogaritur 20 euro për një ditë burgimi, si dhe

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: Arma pistolete të tipit Broving Yapn Fabrik të kalibrit 7.65 mm me nr ser .BB87546 me një karikator me 24 fishekë të kalibrit 7.65x17 mm të precizuara si në dispozitivin e aktakuzës.

I pandehuri obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumë prej **50 € (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.258/2015 të datës 18.11.2016, ka akuzuar V.A, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit. Së bashku me aktakuzë, Prokuroria Themelore, Departamenti për Krime të Rënda, të njëjtën ditë i ka parashtruar gjykatës edhe Marrëveshjen për Pranimin e Fajësisë me të pandehurin V.A, të arritur në prokurori me datë 18.11.2016.

Gjykata pas pranimit të aktakuzës dhe marrveshjes së lartshënuar, mbajti seancë dëgjimore për shqyrtimin e marrveshjes për pranimin e fajësisë, në të cilën prokurori i shtetit deklaroi se tani me të pandehurin V.A, në praninë e mbrojtësit të tij, ka negociuar dhe ka arritur marrëveshje për pranim fajësie, andaj kundër të njëjtit menjëherë ka ngritur aktakuzë PPI.nr.258/15 të datës 18.11.2016 për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, ndërsa sipas marrveshjes së arritur është rekomanduar dënimi me gjobë dhe është propozuar dënim shtesë që arma dhe sendet tjera të precizuara si në aktakuzë, të mbajtura pa autorizim, të konfiskohen. Në vazhdim prokurori njofton gjykatën se paraprakisht

negocimi për arritjen e marrëveshjes ka qenë i lejuar, ndërsa i akuzuari në prani të mbrojtësit të tij ka qenë i paralajmëruar me të gjitha dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë, për çka janë pajtuar në tërësi, andaj meqë marrëveshja e arritur është në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore, i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë.

Gjithashtu marrëveshjen e mbështeti edhe i pandehuri pa vërejtje si dhe dhe mbrojtësi i tij, av. A.R, i cili theksoi se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është iniciuar me propozimin e të mbrojturit të tij, duke u njoftuar paraprakisht për favoret të cilat i ofrohen nga marrëveshja. Kjo marrëveshje mbështetet në prova materiale, e njëjta është e vullnetshme, andaj i ka propozuar gjykatës që ta shqyrtojë dhe ta aprovojë, sa i përket dënimit të rekomanduar, thekson se është i njohur për klientin e tij, andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin t'i përshtatet rrethanave posaçërisht lehtësuese, si koha e kryerjes së veprës penale, pra vepra është kryer në vitin 2014, i pandehuri nuk gjendet në evidenca penale, premtimin se i njëjti do të jetë i kujdesshëm dhe në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, është mbajtës i vetëm i familjes, andaj ka propozuar që të gjitha këto të merren parasysh dhe gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin duke i vlerësuar dhe peshuar këto rrethana t'i shqiptojë minimumin e rekomanduar të dënimit në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata pas konfirmimit se janë përmbushur kushtet e parapara në dispozitën ligjore nga neni 233 të KPP, pa asnjë vërejtje nga palët, me aktvendim, ka aprovuar në tërësi marrëveshjen për pranimin e fajësisë nga i pandehuri V.A dhe, ka urdhëruar që e njëjta të vendoset në shkresë të lëndës. Pas aprovimit të kësaj marrëveshjeje si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, gjykata konstatoi gjendjen e fakteve që e përmbanë akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë dhe i shqiptoi dënimin e rekomanduar, të precizuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese, marrëveshjen e arritur në prokurori për pranimin e fajësisë bashkë me dënimin e rekomanduar, pendimin për veprën e kryer, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me gjobë, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund dhe, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.709/16, me datë 04.07.2017**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.